

“ A e dini se cilat janë të drejtat tuaja? ”



»»» KUSH ËSHTË RREGULLATOR I TË DREJTAVE TUA NJERËZORE?

Kushtetuta e Kanadasë ndan përgjegjësinë ligjore midis qeverisë federale dhe asaj provinciale ose territoriale.

FEDERALE

Qeveria federale kontrollon disa punëdhënës dhe ofrues shërbimesh si bankat dhe linjat ajrore. Ato përshkruhen si “të rregulluara në mënyrë federale”.

Ju mund të informoheni tek:

LIGJI KANADEZ PËR TË DREJTAT E NJERIUT »»» www.laws-lois.justice.gc.ca

PROVINCIAL OSE TERRITORIAL

Provincat dhe territoret rregullojnë ligjërisht/kontrollojnë bizneset dhe ofruesit e shërbimeve dhe kanë ligjet e tyre për të drejtat e njeriut. Ligjet e të drejtave të njeriut për punëtorët e Ontarios ndajnë shumë ngjashmëri me njëra-tjetrën dhe zbatojnë shumë nga të njëjtat parime. Këto ligje mbrojnë njerëzit nga diskriminimi në Ontario.

Ju mund të informoheni tek:

KODI I TË DREJTAVE TË NJERIUT ONTARIO »»» www.ohrc.on.ca

»»» KË MBROJNË KËTO LIGJE?

Pothuajse çdo punëtor. Për të zbuluar nëse rasti juaj është **FEDERAL APO PROVINCIAL**, bisedoni me një oficer të të drejtave të njeriut. Ata do t'ju drejtojnë në vendin e duhur.

»»» ÇFARË LIDHJE KANË TË DREJTAT E NJERIUT ME PUNËN?

» Në Ontario, ju keni të **DREJTËN LIGJORE PËR TRAJTIM TË BARABAR NË PUNË**, pa diskriminim.

» Punësimi përdoret në një mënyrë shumë të përgjithshme dhe përfshin:

- » PUNONJËSIT
- » KONTRAKTORËT E PAVARUR
- » VULLNETARËT

» Sindikata është një shoqatë e organizuar punëtorësh e krijuar për të mbrojtur dhe çuar më tej të drejtat dhe interesat e tyre.

» **PUNËDHËNËSIT DHE SINDIKATAT** kanë një detyrë të përbashkët, të sigurohen që në vendet e punës të mos ketë diskriminim dhe ngacmim.


» Çdo person ka të drejtë për trajtim të barabartë në punë, pa diskriminim ose ngacmim për shkak të racës, prejardhjes, vendit të origjinës, ngjyrës, origjinës etnike, shtetësisë, besimit, seksit, orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes gjinore, moshës, historisë së shkeljeve, statusit martesor, gjendjes familjare ose paaftësisë.

»»» DISKRIMINIMI NË VENDIN E PUNËS

» Diskriminimi është **TRAJTIMI I KEQ NDAJ DIKUJT PËR SHKAK TË NJË PRINCIPI TË MBROJTUR/FAKTORI PËRFAQËSUES**.

Për shembull:

- » RRACA
- » KREDI (FEJA)
- » ORIGJINA ETNIKE
- » ORIENTIMI SEKSUAL
- » MOSHA
- » STATUSI CIVIL
- » AFTËSITË E KUFIZUARA



» Diskriminimi ka **SHUMË FORMA**.

» Diskriminimi mund të **SHËNJOJË** një person ose një grup.

» Mund të jetë e vështirë **PËR T'U PARË** ose mund të jetë pjesë e një sistemi.

» **LIGJET PËR TË DREJTAT E NJERIUT JANË RREGULLUESE**. Kjo do të thotë se ata kanë për qëllim të përmirësojnë situatat e këqija, jo të ndëshkojnë. Ligjet përpiqen të eliminojnë diskriminimin dhe ta parandalojnë atë duke edukuar njerëzit dhe duke krijuar ndërgjegjësim.

SHEMBUJ DISKRIMINIMI:

- » Ju pushojnë nga puna sepse mbeteni shtatzënë (gjini)
- » Jeni pushuar nga puna sepse keni pasur një dëmtim në punë (paaftësi)

»»» NGACMIMI: NJË PRAKTIKË E PËRBASHKËT DISKRIMINUESE

NGACMIMI NDODH KUR DIKUSH:

01

JU OFENDON OSE JU POSHTËRON fizikisht ose verbalisht.

02

JU KËRCËNON OSE FRIKËSON.

03

Bën **VËREJTJE OSE SHAKA TË PAKËNDSHME/ JOMIKPRITËSE** për racën, fenë, gjininë, moshën, paaftësinë, etj.

04

Bën **KONTAKT FIZIK** të panevojshëm me ju, si prekje, përkëdhelje, grushtim, pickim - që mund të jetë gjithashtu sulm.

! EmPunëdhënësit janë përgjegjës për çdo ngacmim në vendin e punës dhe ata **DUHET TË NDËRMARRIN VEPRIMET E DUHUR** ndaj çdo punonjësi që ngacmon dikë tjetër.

»»» BËRJA E NJË ANKESA

AFATI KOHOR

Ju duhet të paraqisni ankesën tuaj brenda

NJË (1) VITIT nga data në të cilën ka ndodhur diskriminimi ose nëse ka pasur një sërë ngjarjesh brenda **NJË (1) VITI** nga ngjarja e fundit.

KU TË DREJTOHESH

KODI I TË DREJTAVE TË NJERIUT ONTARIO

Ankesat për të drejtat e njeriut që i përkasin këtij kodi prezantohen në **Gjykatën e të Drejtave të Njeriut, Ontario:**

1-866-598-0322

WWW.HRTO.CA

LIGJI KANADEZ PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Ankesat për të drejtat e njeriut që bien nën këtë Akt prezantohen në **Komisionin Kanadez të të Drejtave të Njeriut:**

1-888-214-1090

WWW.CHRC-CCDP.GC.CA

»»» DETYRIMI PËR AKOMODIM/PËRSHTATJE

Ndonjëherë punëdhënësit dhe sindikatat duhet të ndërmarrin hapa të nevojshme **QË TË BËJNË TË MUNDUR QË NJERËZIT TË PUNOJNË**.

Kjo quhet detyrë për të akomoduar/përshtatur.

Detyra për të akomoduar/përshtatur është një **PËRGJEGJËSI E NDARË MES PUNËDHËNËSVE, PUNËTORËVE DHE SINDIKATAVE**.

DETYRA E PËRSHTATJES DO TË KRIJOJË AKSES TË BARABARTË NË PUNË DUKE HEQUR PENGESAT.

SHEMBUJ TË AKOMODIMIT/PËRSHTATJES NË VENDIN E PUNËS:

AFTËSISË TË KUFIZUARA

Ristrukturimi i një pune ose vendit të punës dhe rikualifikimi ose ricaktimi i vendit të punës pas një dëmtimi, sëmundjeje ose varësie.

SHTATZANIA

Sigurimi i pushimeve fleksibël dhe planifikimi i vizitave të mjeku.

FEJA DHE BESIMET

Lejimi i një punonjësi që të mos punojë në festa të caktuara fetare.

